REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 3888 **Prot** **Maliq, më: 26.06.2026**

V E N D I M
Nr. 84, datë 25.06.2026
Mbi përditësimin dhe saktësimin e Regjistrit Kombëtar të Adresave dhe saktësimin e kufijve territorial në Njësi Administrative (rendi 4) dhe kufi fshati (rendi 5).

Bazuar në ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar neni 8, pika 2, neni 9 pika ½ germa "b", neni 64 "Detyrat dhe Kopetencat e Kryetarit, neni 93 pika 2, ligji nr. 115/2014 datë 31.7.2014 "*Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*"; ligjit 9270 datë 29.07.2004 "Për Sistemin e Adresave" i ndryshuar neni 4/3 "Dhënësit e informacionit në RKA", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1078, datë 23.12.2015, Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, Tema - Kufijtë e njësive administrative"; Vendimi nr. 360 datë 29.05.2019 "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore"; Shkresa nga Ministria e Punëve të Brendshme nr 2880 Prot .datë 01.06.2026 "Kërkesë për përditësimin dhe saktësimin e Regjistrit Kombëtar të Adresave dhe saktësimin e kufijëve territoriale"protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr. 3466 prot datë 04.06.2026. Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë përditësimin dhe saktësimin e Regjistrit Kombëtar të Adresave dhe saktësimin e kufijve territorial në Njësi Administrative (rendi 4) dhe kufi fshati (rendi 5).

2. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe vazhdimin e procedurave për dërgimin e dokumentacionit ngarkohet Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Sektori i Pyjeve dhe Kullotave.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

Miratuar me 21 vota
Vota pro 21
Vota kundër 0
Vota apstenim 0
Zbardhur më datë 26.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA MALIQ